



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:092764  
Datë: 13.08.2024  
Numri i dokumentit: 06045017

**K.Dh.Shk II.nr.1165/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “BANKA CREDINS” Sh.A., NIPT K31608801O, me seli në Tiranë Rr.”Pashko Vasa” nr.8, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Editon Osmani, avokat nga Prishtina, Rr.”Sylejman Vokshi” H19, Nr.4, kundër debitorëve 1.) N.N.P. “MATI-COM”, NRB:70937727, përfaqësuar nga B.K., me seli në fshatin ...c, Malishevë, 2.) B.K.1., nga fshati ..., Malishevë, 3.) F.K., nga fshati ..., Malishevë, 4.) E.P., nga fshati ..., Malishevë dhe 5.) B.P. nga fshati ..., Malishevë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024, me datë **13.08.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorëve 1.) N.N.P. “MATI-COM”, NRB:70937727, 2.) B.K.1., 3.) F.K., 4.) E.P., dhe 5.) B.P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorëve 1.) N.N.P. “MATI-COM”, NRB:70937727, 2.) B.K.1., 3.) F.K., 4.) E.P., dhe 5.) B.P., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.246/21 të datës 07.04.2021, të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024, dhe të bëhet vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditore ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se aktvendimi i shkallës së parë është plotësisht i bazuar dhe i mbështetur në gjendjen faktike si dhe dispozitat ligjore. Andaj, gjykatës së shkallës së dytë i ka propozuar që ankesën e debitorëve ta refuzoj si të pabazuar dhe të vërtetojë vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024.

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbarimor me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Kontratës së Kredisë Afatgjate me numër 5633 e datës 20.07.2016, nr.6965 Rep., nr.2214 Kol dhe Kontratën mbi Hipotekën LRP.nr.3890/2016 e datës 22.07.2016, e regjistruar sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr.prot.06-448-2016, i datës 22.07.2016, duke detyruar debitorët t'ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 424,747.69 €, si dhe kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrij deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të gjitha në afat prej 7 ditësh, duke lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit, me shitjen, zbrazjen dhe dorëzimin në pronësi dhe posedim të paluajtshmërisë.

Kundër urdhrit përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim kanë ushtruar debitorët i parë dhe i dytë, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor si të pa bazuar dhe të parashkruar, ndër të tjerash kanë theksuar se dokumenti nuk e ka titullin përmbarimor dhe se kreditore ka kërkuar përmbarimin e kontratës së kredisë e cila nuk përmban klauzolën e ekzekutueshmërisë dhe as të përmbarimit si i tillë është kontestuese në bazë të ligjit për procedurën përmbarimore nuk është dokument përmbarimor. Tutje ka shtuar se vendimi me të cilin ka kërkuar përmbarimin kreditorit është i datës apo vitit kalendarik 2013 ndërsa propozimin e ka dorëzuar me datën 08.05.2019, që i bie që është 4 vite jashtë afatit ligjor. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të refuzohet propozimi për përmbarim.

Debitorët i katërt dhe i pestë kanë parashtruar prapësim përmes të cilit e kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash kanë theksuar se nuk e kontestojnë borxhin që kanë ndaj kreditorit por kërkojnë që fillimisht të sekuestrohen pronat e paluajtshme dhe të luajtshme të debitorit të parë, dytë dhe tretë në mënyrë që këtë borxh ta shlyen pasi që ka pasuri të luajtshme dhe të pa luajtshme. Kanë shtuar se sa i përket bazës ligjore se si ka pasur të drejtë në marrje të kredisë nga qytetari i Republikës së Kosovës tek kreditore, nuk është e qartë pasi që asnjëri nga

debitorët nuk kanë shtetësinë e Republikës së Shqipërisë dhe nuk jetojnë e as punojnë në Shqipëri. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar, të refuzohet urdhri përmbarrimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimi, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.795/22 të datës 15.03.2024, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor paraqet dokument përmbarrimor, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar në Kontratën e Kredisë Afatgjate me numër 5633 e datës 20.07.2016, nr.6965 Rep., nr.2214 Kol dhe Kontratën mbi Hipotekën LRP.nr.3890/2016 e datës 22.07.2016, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuara pranë organit kompetent, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. prot. 06-448-2016, i datës 22.07.2016, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, dhe të njëjtat paraqesin dokumente përmbarruese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbarruese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet debitorëve se Gjykata Komerciale e Kosovës nuk është kompetente që të trajtoj këtë kontest pasi që vendimi final i gjykatës shqiptare duhet ti nënshtrohet njohjes nga gjykata kompetente e Kosovës, mirëpo këto pretendime nuk janë relevante për të vendosur ndryshe pasi që bazuar në nenin 191 të LPP-së parashihet se “Për të vendosur për propozimin për përmbarrimin për sendet e paluajtshme dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbarrimin, përmbarruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarrimor dhe të zbatojë përmbarrimin”, andaj Përmbarruesi Privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarrimor dhe të zbatojë përmbarrimin.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.SH.II nr.1165/24 me datë 13.08.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**